

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 325, Datë 15.12.2025

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “AGE ERZEN” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETVE TË SAJ SI MJET PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE-s) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2677/2 prot., datë 13.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatohet se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e Kërkesës për Autorizim

- Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024, nga HEC “Hekali” me kapacitet prodhues 1.94 MW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.
- Me shkresën nr. 2430/2 prot., datë 22.09.2025 shoqëria ka paraqitur kërkesë/dokumentacion në lidhje me kërkesën për miratim të transferimit të aseteve që i shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar, për të përmbushur detyrimin ndaj Banka OTP Albania sh.a..

2. Fillimi i Procedurës për transferimin e aseteve

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 251, datë 08.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.
- ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 2430/6 prot., datë 16.10.2025 dhe MIE-n nëpërmjet shkresës nr. 2430/14 prot., datë 31.10.2025, në lidhje me këtë vendim.

3. Procedura vijuese dhe Vlerësimi i dokumentacionit

- Me shkresën nr. 2430/6 prot., datë 16.10.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.
- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2430/9 prot., datë 24.10.2025, depozitoi dokumentacion/informacion shtesë, nga analizimi i të cilit u konstatua mungesa e listës së detajuar të aseteve fikse me vlerat përkatëse dhe totale të tyre.
- ERE me shkresën nr. 2430/13 prot., datë 31.10.2025 njoftoi shoqërisë mbi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 05.11.2025, për të sqaruar sa munguar në këtë aplikim.
- Shoqëria me shkresën nr. 2430/17 prot., datë 02.12.2025 sqaron se nuk disponon një listë asetesh, e se do të ketë një të tillë vetëm pas përfundimit të ndërtimit, kualidimit, testimit të veprës.
- Si e tillë, ERE vlerësoi të nevojshme komunikimin me bankën për të sqaruar/rakorduar me sa deklaruar nga ana e subjektit, ndaj nëpërmjet emailit të datës 09.12.2025, protokolluar me nr. 2430/18 prot., datë 09.12.2025 i ka kërkuar bankës sqarim/të bëjë me dije nëse disponojnë një listë asetesh si pjesë integrale e kontratave të nënshkruara.
- Banka në përgjigje me emailin e datës 11.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 2430/19 prot., datë 11.12.2025 ndër të tjera referon se: informacion me të detajuar përsa i përket vlerës së investimit që pritet të kryhet nga shoqëria për realizimin e HEC “Hekali”, specifikon se mund të vihen në dispozicion nga vetë shoqëria, si dhe se në të dyja kontratat i referohet aseteve të tashme e të ardhshme, duke i venë një vlerë sipas projektit financiar të përcjellë nga shoqëria.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së bordit

- Për të gjitha sa më sipër vlerësohet të bëhen sqarimet përkatëse me subjektin kërkues dhe bankën në lidhje me procedurën që ndjek/trajton ERE në kuptim të akteve ligjore dhe nënligjore, ndaj vlerësohet të zgjaset me 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a..
- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese. Brenda 20 ditëve duhet të plotësohet informacioni /dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.
2. Brenda 20 ditëve duhet të plotësohet informacioni/dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “AGE ERZEN” sh.p.k. dhe Banka OTP Albania sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI